



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T

i mbledhjes së parë të Komitetit për Komunitete, mbajtur më 17.1.2025, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Mirsada Behluli, Arton Brahim, Elmira Nikçi - Rexha, Nenad Miladinović, Kimeta Shok, Oktay Kurtesh, Faton Marolli dhe Adnan Ajeti.

Mungoi: Tiera Kasumi - Berisha.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Fisnik Dida, zyrtar nga OSCE-ja, Arianita Beqa – Rraci, zyrtare nga UNMIK-u, Qefsere Berisha – Xhelili, zyrtare nga ZKKK, Egzon Pacolli, zyrtar nga Burimet njerëzore të Komunës së Prishtinës, Edis Prapashtica - zyrtar nga Burimet njerëzore të Komunës së Prishtinës.

Mbledhjen e hapë dhe e kryesoi kryesuesja e Komitetit, znj. Mirsada Behluli, me këtë

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Analiza e punës dhe shqyrtimi i aktiviteteve të Komitetit për Komunitete gjatë vitit 2024;
3. Shqyrtimi i kërkesave nga të gjitha komunitetet joshumicë për të ofruar ndihmë për kremtimin e festave kombëtare;
4. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave në bazë të prioritetit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor dhe të për muajt dhjetor të ZKKK-së 2024;
6. Formimi i komisionit lidhur me takimin me zyrtarët e Minsitrisë së Komuniteteve dhe Kthimit:
 - a) subvencionimi nga MKK;
 - b) propozim për ndihmë tjetër për komunitetet joshumicë;
7. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësitë e tyre;
8. Të ndryshme.

Njëzëri u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Faqe 1 nga 5

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Pika e dytë

Analiza e punës dhe shqyrtimi i aktiviteteve të Komitetit për Komunitete gjatë vitit 2024.

Mirsada Behluli, i njoftoi të pranishmit lidhur me punën dhe aktivitetet e Komitetit për Komunitete gjatë vitit 2024, ku dhe ceku disa prej tyre: janë mbajtur 11 mbledhje të Komitetit për Komunitete, kemi pasur takime me drejtorët dhe zyrtarët e drejtorive të Komunës së Prishtinës, si p.sh. me Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, Drejtorinë e Arsimit, Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Po ashtu, kemi pasur takim me Kryetarin e Kryeqytetit, pastaj me ZKKK-në, me zyrtarët e OSCE-së, me Policinë e Kosovës, KFOR-in etj.

Ajo mes tjerash tha se i kemi shqyrtuar ankesat dhe kërkesat e përfaqësuesve të komuniteteve, duke pasur parasysh gjendjen e tyre ekonomike – sociale, si dhe kemi identifikuar familjet të cilat janë në gjendje të rëndë ekonomike etj.

Nenad Miladinovic, duke u ndërlidhur në diskutim për këtë pikë të rendit të ditës, ai tha se sa i përket analizës së punës së Komitetit për Komunitete, e që ka të bëjë me pjesën ku jeton komuniteti serb kur është në pyetje ndriçimi kemi shumë probleme dhe për këtë dua të falënderoj z. Bashkim nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, i cili e kryen punën shumë mirë. Ai në vazhdim tha se sa i përket mbeturinave, Kompania e Pastrimit, mund të them se rregullisht i mbledh mbeturinat me kohë, pra kur janë ata në pyetje nuk kemi kurrfarë problemi, mirëpo kur janë në pyetje problemet të cilat shumë herë i kam shtruar në këtë komitet nuk është bërë asgjë në atë drejtim gjatë vitit 2024, ku në pyetje është pastrimi i mbeturinave, mund të them se asgjë nuk është pastruar. Ndërsa sa i përket asfaltimit të rrugës prej 200 metrave, ajo është kryer, por kur është në pyetje rruga prej 2 kilometrave që është nga viti 2020 ende nuk është bërë asgjë, ku punimet kanë filluar në fund të muajit nëntor në vitin 2023 dhe ende nuk kanë përfunduar, Po ashtu edhe shtrati i lumit nuk është pastruar edhe pse kur Kryetari i komunës ka premtuar që do të pastrohet nuk është pastruar. Pra në vazhdim kisha dashur me cekur se ujësjellësi në Slivovë ende nuk është kryer.

Elmira Nikçi Rexha – tha se kërkoj mirëkuptimin tuaj për pikën të ndryshme pasi që e kemi këtu përfaqësuesin e burimeve njerëzore apo thënë ndryshe menaxherin e burimeve njerëzore z.Egzon Pacolli, meqë i kemi dy anëtarë të komitetit që janë Arton Brahimi dhe Faton Marolli, të cilët nuk marrin mëditje siç marrim të gjithë ne, për çka ndjej shqetësim për këtë. Ajo në vazhdim tha se e kemi konsultuar ligjin ku ligji i jep dy mundësi. Nën 1) ndalohet si zyrtar apo si shërbyes civil i komunës, por ekziston një tjetër rrugë që është një marrëveshje për punën me vëllim të shtuar. Pra kisha kërkuar nga menaxheri i burimeve njerëzore që mundësisht të na sqaroj mundësinë se si këta dy anëtarë të komitetit të përfshihen në pjesën e pagesës.

Egzon Pacolli – duke u ndërlidhur në diskutim tha se këtë problem e kam diskutuar me Fatonin herën e kaluar. Meqë shërbyesit civilë në rastet e komisioneve nuk paguhet, mirëpo shërbyesi civil në këtë rast i ka dy mundësi, vëllimi i punës dhe pagesa për punë shtesë në orar dhe jashtë orarit të punës. Andaj ju lus si komitet të bëni një kërkesë me të cilën kërkohet që të rregullohet kjo çështja e dy zyrtarëve në fjalë, ku pastaj obligohen shëfat apo udhëheqësit e tyre t'i parashohin çdo muaj. Ndërsa sa e shoh unë e vetmja mundësi që do të ishte e realizueshme është pagesa për punë shtesë.

Mirsada Behluli - tha se unë mendoj se ne si Komitet për Komunitete duhet t'i përkrahim pasi që ata na ndihmojnë dhe angazhohen në vizita që bënë komiteti nëpër shkolla dhe në angazhime tjera.

Nenad Miladinovic – tha se më vjen mirë që e keni potencuar këtë çështje pasi që unë kam biseduar edhe me disa anëtarë tjerë të komiteteve në komunat e tjera dhe jam befasuar se ata marrin mëditje, ndërsa tek ne jo. Pra do të thotë se nuk është ndonjë vendim në nivel qendror, por është vendim në nivel lokal.

Elmira Nikçi Rexha – duke u ndërlidhur në diskutim tha se kjo është në nivel qendror, por mendoj se ata i marrin në mëditje për orë shtesë, pasi që kjo shkon përmes thesarit.

Pika e tretë

Shqyrtimi i kërkesave nga të gjitha komunitetet joshumicë për të ofruar ndihmë për krenimin e festave kombëtare

Mirsada Behluli – sa i përket kësaj pike të rendit të ditës tha se kisha dashur të di se a duhet t'i shkruhet kërkesë Drejtorisë së Kulturës, si dhe a duhet të gjithë ne të bëjmë kërkesë tani pasi që në muajin mars bëhet publikimi i kërkesave, pasi që komuniteti ashkali ditën kombëtare e ka në muajin shkurt.

Nenad Miladinovic – lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se unë nuk mundem t'ju ndihmoj shumë pasi që nuk jam aq shumë në rrjedha, sepse komuna lidhur me këtë çështje ka ndërruar qëndrime. Mirëpo mund të ju them se unë më herët kam kontaktuar me Kryetarin e komunës dhe kryetari i ka adresuar tek drejtoritë kompetente.

Pika e katërt

Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave në bazë të prioritetit

Mirsada Behluli – lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se ne kemi pasur kërkesat tona për infrastrukturë dhe kërkesa të natyrave të tjera siç janë investimet kapitale, si dhe kërkesat që kanë të bëjnë me komunitetet joshumicë.

Nenad Miladinovic - duke u ndërlidhur në diskutim tha se kur janë në pyetje këto kërkesa kjo ka të bëjë me kërkesat individuale dhe kërkesat e qytetarëve nga komunitetet joshumicë. Sa i përket projekteve për të cilat ju flisni, ato nuk zgjidhen këtu, ju kisha lutur të mos i përziejmë. Ai në vazhdim tha se kjo pikë e rendit të ditës ka të bëjë se a ka pasur në ndërkohë ndonjë kërkesë individuale dhe të qytetarëve nga komunitetet joshumicë.

Oktay Kurtesh – tha se unë e njoh një rast (një grua), të cilën e kanë heq prej shtëpisë dhe, megjithëse kanë thënë se do ia paguajnë qiranë, mirëpo nuk e di se a ia paguajnë qiranë. Ai në vazhdim tha se sa e di unë, Drejtoria e Mirëqenies Sociale i ka paguar nga 100 euro si ndihmë sociale. Pra ne kemi pasur kërkesë që t'ia paguajnë qiranë pasi që e kanë heq prej shtëpisë së vetë.

Elmira Nikçi Rexha – duke iu drejtuar z. Kurtesh shtroi pyetje se kush e ka larguar nga shtëpia dhe për çfarë arsye e kanë larguar prej shtëpisë.

Oktay Kurtesh – duke iu përgjigjur znj. Nukçi – Rexha tha se ajo nga shtëpia është larguar për shkak të sigurisë pasi që shtëpia ka qenë e vjetër duke u rrënuar.

Elmira Nikçi Rexha - tha se këto raste i takojnë Ministrisë së Kulturës, pra shtëpitë nën mbrojtje.

Pika e pestë

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor dhe për muajin dhjetor të ZKKK-ës 2024.

Njëzëri u miratua Raporti vjetor dhe për muajin dhjetor të ZKKK-ës 2024.

Pika e gjashtë

Formimi i komisionit lidhur me takimin me zyrtarët e Ministrisë së Komuniteteve dhe Kthim

Nenad Miladinovic – lidhur me formimin e Komisionit për takimin me zyrtarët e MKK-ës propozoi që ky formimi i komisionit të shtyhet pas zgjedhjeve. Njëzëri u miratua propozimi i z. Miladinovic.

Pika e shtatë

Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësitë e tyre

Kimeta Shok – nuk kisha për të thënë diçka, veçanërisht janë shpërndarë pakot, është bërë pagesa për dru zjarri.

Nenad Miladinovic - nuk kemi asnjë problem dhe nuk kisha pasur diçka tjetër me thënë.

Oktay Kurtesh – sa i përket kërkesave, kërkesa nuk kemi vetëm se në emrin tim dhe të gjithë atyre që kanë marrë pagesat për dru zjarri, do doja ta falënderoja komunën dhe kryetarin me ekipin e tij.

Faton Marolli - tha se nuk kam asgjë tjetër të them vetëm se desha ta falënderoj Komunën e Prishtinës, kryetarin, që kanë gjetur kohë dhe vullnet për të na ndihmuar.

Arton Brahimi – po ashtu tha se nuk kam se çka të them vetëm se desha të falënderoj të gjithë kolegët dhe t'ju uroj një vit të mbarë dhe suksese në punë.

Takimi i radhës do të mbahet më dt. 18.2.2025

Procesmbajtësja
Lendita Spahija

Kryesuesja e Komitetit
Dr. Mirsada Behluli



Faqe 5 nga 5